



PRESIDENTJA OSMANI PËRFSHIHET NË DEBATIN PËR HAPJEN
E URËS SË IBRIT PËR LËVIZJEN E AUTOMJETEVE

ALEATËT PO KËRKOJNË QË HAPJA E URËS SË IBRIT TË JETË E PËRHERSHME, JO E ÇASTIT

FAQE 3



Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Kosova duhet të sigurohet që ura në veri të hapet në atë mënyrë që nuk nxit konflikt me aleatët e as prani të shtuar të misionit të NATO-s në vendin tonë. Ajo ka thënë se

ShBA-ja asnjëherë nuk ka qenë kundër hapjes së urës së Ibrit. Në këtë kontekst, Osmani ka thënë se aleatët e Kosovës janë duke kërkuar që hapja e urës të jetë sukses i përhershëm, jo i çastit. Osmani ka

thënë se Kosova nuk duhet ta pyesë Serbinë për hapjen e urës dhe se kjo çështje s'ka pse të diskutohet në dialogun e Brukselit. Sipas saj, deklaratat e fundit të BE-së në këtë temë janë "raciste"

KURTI I OFRON BASHKËPUNIM SHEFES SË ZYRËS SË KE-së NË KOSOVË

F. 5



VENDIMI PËR SUBVENCIONIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE, PDK-JA AKUZON MINISTREN NAGAVCI PËR ZHVATJE TË BUXHETIT TË SHTETIT

F. 7



ISH-FOTOGRAFI PERSONAL VIZITON THAÇIN NË HAGË: AI PO E MBRON KOSOVËN

F. 3

HAMZA: MITROVICA S'ËSHTË VETËM MINIERË E ARIT, POR EDHE E KULTURËS DHE E EMANCIPIIMIT

F. 3

KSHC-JA AKREDITON FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE PROGRAMET NË FAKULTETIN E ARTEVE

F. 7

EKONOMI



MBI 18 MILIONË EURO PËR SHESHIN "XHORXH BUSH", KOMUNA E PRISHTINËS NIS PROCEDURAT

F. 8

PAQARTËSI PËR INVESTIMET NGA DIASPORA NË KOSOVË

F. 8

SPORT

KRYEMINISTRI RAMA PËRGËZON EKIPIN OLIMPIK PËR SUKSESIN HISTORIK

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

UNESCO: Regjimi taliban ua mohoi qëllimshëm shkollimin 1.4 milion vajzave afgane

KABUL, 15 GUSHT - Të paktën 1.4 milion vajzave në Afganistan u është mohuar qasja në arsimin e mesëm qëkur talibanët u kthyen në pushtet në vitin 2021, ka njoftuar UNESCO. “Në vetëm tre vjet autoritetet de facto pothuajse kanë zhdukur dy dekada të përparimit të qëndrueshëm për arsimin në Afganistan dhe e ardhmja e një brezi të tërë tani është në rrezik”, tha agjencia në një deklaratë.

Këto të dhëna janë bërë publike pasi talibanët shënuan tre vjet qëkur forcat e tyre pushtuan kryeqytetin e Afganistanit, Kabul, më 15 gusht 2021, pasi Qeveria e mbështetur nga ShBA-ja ra dhe udhëheqësit e saj u larguan në mërgim.

Që nga kthimi i talibanëve në pushtet gratë janë përjashtuar nga jeta publike – atyre u është ndaluar të bëjnë shumë punë, u janë ndaluar parqet si dhe palestrat - dhe u është ndaluar arsimi i mesëm dhe i lartë.

Kufizimet arrijnë në atë që Kombet e Bashkuara e kanë përshkruar si “aparteid gjinor”.

Aktualisht janë gati 2.5 milionë vajza janë të privuara nga e drejta e tyre për arsimim, që

përfaqësojnë 80 për qind të vajzave afgane të moshës së shkollës, tha UNESCO-ja. Kjo përfaqëson një rritje të numrit prej 300 mijë vajzave nga të dhënat e mëparshme të agjencisë së OKB-së në prill të vitit 2023.

“Si rezultat i ndalesave të vendosura nga autoritetet, të paktën 1.4 milion vajzave u është mohuar qëllimisht qasja në arsimin e mesëm që nga viti 2021”, bëri me dije UNESCO.

Qasja në arsimin fillor ka rënë ndjeshëm, me 1.1 milion më pak vajza dhe djem që ndjekin shkollën, shtoi agjencia. Për këtë, fajësohen vendimet e autoriteteve për t'i ndaluar mësueset femra të mësojnë djemtë, si dhe mungesën e nxitjes për prindërit për t'i dërguar fëmijët në shkollë.

Agjencia është “e alarmuar nga pasojat e dëmshme të braktisjes së shkollës të kësaj shkalë, gjithnjë e më masive, e cila mund të çojë në një rritje të numrit të fëmijëve që punojnë dhe martesave të hershme”.

Regjistrimi në arsimin e lartë është po aq shqetësues, thuhet në deklaratë, duke shtuar se numri i studentëve në universitetet është



ulur 53 për qind që nga viti 2021. Drejtoresha e përgjithshme e UNESCO-s, Audrey Azoulay, i kërkoi komunitetit ndërkombëtar të mobilizohet “për ta siguruar rihapjen e pakushtëzuar të shkollave dhe universiteteve për vajzat dhe gratë afgane”.

Mungesa e përfshirjes në arsim ka qenë ndër pikat kryesore të

kritikave të afganëve ndaj autoriteteve talibane. “Ka nga ata që nuk janë mjaftueshëm të shkolluar dhe, më e rëndësishmja, një pjesë e shoqërisë, gratë, janë të privuara nga arsimi, dhe ky është një problem i madh për popullin e Afganistanit”, tha për “Radio Azadi” të “Radios Evropa e Lirë”, një burrë afgan, banor i provincës

veriore të Balkhut, i cili preferoi të mbetej anonim për shkak të shqetësimeve për sigurinë e tij.

“Çështjet e arsimit - arsimimi dhe punësimi i grave - dhe pjesëmarrja e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar janë anuluar plotësisht dhe janë lënë anash”, tha një grua banore e Kabulit, e cila preferoi të mos i përmendet emri.

Talibanët festojnë kthimin e tyre në pushtet në mes të gushtit, në datën e rënies së Kabulit dhe në fund të muajit, kur trupat e fundit ndërkombëtare të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara, u larguan nga Afganistani.

Tërheqja, për të cilën u pajtuan Shtetet e Bashkuara dhe regjimi taliban më 29 shkurt 2020, ia mundësoi lëvizjes radikale islamiste të kthehet në pushtet 20 vjet pasi ishte rrëzuar nga forcat amerikane, menjëherë pas sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara më 11 shtator 2001. Organizatat ndërkombëtare humanitare kanë paralajmëruar se miliona afganë po luftojnë me “një nga krizat humanitare më të rënda dhe më komplekse në botë, tre vjet pas ndryshimit të pushtetit”.

Shkarkohet nga detyra kryeministri i Tajlandës, emëroi ministër një person që kishte bërë burg



BANKOK, 15 GUSHT - Kryeministri i Tajlandës, Srettha Thavisin, është shkarkuar nga detyra pasi një gjykatë vendosi se ai kishte shkelur Kushtetutën, një vendim tronditës që e zhyt mbretërinë në pasiguri të mëtejshme politike.

Vendimi vjen një javë pasi e njëjta gjykatë shpërndau Partinë Popullore Progresive të vendit Lëviz Përpara, e cila fitoi më shumë vende në zgjedhjet e vitit të kaluar dhe ndaloi liderët e saj nga politika për 10 vjet.

Gjykata Kushtetuese në Bangkok vendosi të mërkurën se Srettha,

një manjat i pasurive të paluajtshme, kishte shkelur rregullat e etikës duke emëruar një avokat që kishte vuajtur burg në kabinet. Pesë nga nëntë gjyqtarët e gjykatës votuan për shkarkimin e Sretthas dhe kabinetit të tij, duke vendosur se kryeministri ishte “i vetëdijshëm se ai emëroi një person të cilit i mungonte seriozisht integriteti moral”.

Tani duhet të formohet një qeveri e re dhe koalicioni qeverisës i udhëhequr nga Pheu Thai do të emërojë një kandidat të ri për kryeministër, i cili do të votohet

nga parlamenti me 500 vende. Duke folur pas vendimit, Srettha tha se ai e kreu detyrën e tij si kryeministër sa më mirë që mundi dhe tha se “e pranon verdiktin”. Verdikti do të thotë më shumë trazira për peizazhin tashmë të trazuar politik të Tajlandës. Gjatë dy dekadave të fundit dhjetëra ligjvënës janë përballur me ndalime, partitë janë shpërbërë dhe kryeministrat janë rrëzuar me grusht-shteti ose me vendime gjyqësore, me gjyqësorin që luan një rol qendror në betejën e vazhdueshme për pushtet.

Ministria e Shëndetësisë në Gaza: Më shumë se 40 mijë persona janë vrarë nga lufta

GAZA, 15 GUSHT - Më shumë se 40 mijë palestinezë janë vrarë si rezultat i aksionit ushtarak izraelit në Gaza që nga sulmi i 7 tetorit të udhëhequr nga Hamasi ndaj Izraelit, ka thënë Ministria e Shëndetësisë e drejtuar nga Hamasi.

Ky numër, 40 005 të enjten, barazohet me rreth 1.7 për qind të popullsisë 2.3 milionëshe të enklavës palestineze, një tjetër tregues i kostos njerëzore të luftës. Krahas viktimave, analiza e

imazheve satelitore sugjeron se gati 60 për qind e ndërtesave në Gaza janë dëmtuar ose shkatërruar që nga fillimi i luftës.

Në muajt e fundit qyteti jugor Rafah ka pësuar dëmtimin më të madh, tregojnë imazhet. Shifrat e Ministrisë së Shëndetësisë për numrin e të vrarëve nuk bëjnë dallime mes civilëve dhe luftëtarëve. Megjithatë, sipas raporteve, shumica e viktimave janë fëmijë, gra ose të moshuar, raporton “BBC”.

Disa ekspertë kanë thënë se numri aktual i njerëzve të vrarë ka të ngjarë të jetë shumë më i lartë, me zyrtarët që vlerësojnë se rreth 10 000 trupa mbeten nën rrënojat e ndërtesave të goditura nga sulmet ajrore izraelite. Dhe madje edhe me ndalimin e luftimeve, studiuesit theksojnë se, përveç numrit të njerëzve të vrarë si rezultat i drejtpërdrejtë i luftës, shumë të tjerë mund të vdesin nga shkaqe indirekte, si sëmundjet dhe uria.



Ish-fotografi personal viziton Thačin në Hagë: Ai po e mbron Kosovën

HAGË, 15 GUSHT - Fotografi Astrit Ibrahimimi ka vizituar ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në Hagë. Në "Facebook", ku ka ndarë një fotografi të realizuar disa vjet më parë krah tij, Ibrahimimi ka thënë se Thaçi në Hagë është duke e mbrojtur Kosovën. "Sapo isha në Hagë të presidenti Thaçi. Me të kam kaluar një pjesë të madhe të

jetës profesionale por edhe thjesht njerëzore. Atje është tu e mbrojtë Kosovën dhe krejt neve. Më pëlqeu optimizmi i pashoq i tij dhe po kthehem me bindje që kjo valë e optimizmit të tij me një moment do të sjellë një cunami të progresit për krejt neve", ka shkruar Ibrahimimi. Astrit Ibrahimimi ka qenë fotograf personal i Hashim

Thaçit. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në Qendrën e Paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat që ngarkohen nga Gjykata Speciale.



Ish-pjesëtari i UÇK-së, Blerim Ramadani, arratiset nga arresti shtëpiak

SHKUP, 15 GUSHT - Ish-pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Blerim Ramadani, i arrestuar muajin e kaluar nga policia maqedonase, ka ikur nga arresti shtëpiak - nga shtëpia e të afërmeve të tij në Maqedoninë e Veriut. Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut ka thënë të enjten për agjencinë e lajmeve "MIA" se është duke marrë masa për gjetjen e vendndodhjes së Ramadani. Ramadani është arrestuar më 17 korrik në pikëkalimin kufitar Jazhincë që lidh Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga gjykata në Beograd përmes Interpol Serbia, me akuza për krime lufte. Një gjykatë maqedonase më 1 gusht ka urdhëruar që

Ramadani të dërgohet nga paraburgimi në arrest shtëpiak dhe, sipas vendimit, ai është dërguar në një adresë në Shkup. Me këtë vendim ishte paraparë që ai të qëndronte në arrest shtëpiak deri më 16 gusht. Autoritetet serbe e akuzojnë Ramadani se ka kryer krime lufte në rajonin e Nerodimes verën e vitit 1999, sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Kosovës (MPJD). Ramadani, sipas MPJD-së, ka qenë anëtar i Zonës Operative të Nerodimes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Së fundi, autoritetet në Serbi kanë arrestuar edhe katër shtetas të Kosovës, të cilët Beogradi i ka akuzuar për krime lufte. Autoritetet e Kosovës e kanë cilësuar arbitrar dhe të padrejtë arrestimin në Serbi të



qytetarëve të Kosovës për këto akuza dhe kanë kërkuar ndihmën e faktorit ndërkombëtar për lirin e tyre. Në fillim të korrikut, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, përmes një letre dërguar homologues serbe, kishte kërkuar transferimin e shtetasve të

Kosovës që po mbahen në Serbi. Pikëkalimi mes Kosovës dhe Serbisë, Merdar, është një prej zonave ku autoritetet serbe kanë arrestuar shtetas të Kosovës. Megjithatë, Haxhiu kishte deklaruar se vështirë se Serbia do t'i përgjigjet kërkesës së autoriteteve të Kosovës për

ekstradimin e shtetasve të Kosovës për shkak të mosbashkëpunimit të vazhdueshëm juridik. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kishte deklaruar se shteti i tij ka juridiksion të njohur ndërkombëtarisht mbi trajtimin e veprave që kryhen brenda territorit të saj. Serbia, në strategjinë e vet kombëtare 2021-2026 për ndjekje të krimeve të luftës, pretendon se ka juridiksion për të vënë drejtësi për krimet e kryera gjatë konflikteve të armatosura në vitet '90. Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike në vitin 2013, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, por bashkëpunim në mes të tyre për rastet e krimeve të luftës nuk ka pasur pothuajse fare.

Në shtator hapet konkursi për rekrutimin e 300 ushtarëve të rinj

PRISHTINË, 15 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije se në muajin shtator do të hapet konkursi për rekrutimin e 300 ushtarëve të rinj të cilët në muajin nëntor do ta fillojnë trajnimin bazë. Maqedonci ka treguar se deri më tani janë rekrutuar 1 931 ushtarë dhe kadetë, ndërsa në proces janë edhe 40 të tjerë. "Sepse ushtria njëmend është prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Brenda këtij mandati deri më tani rekrutuam 1 931 ushtarë dhe



kadetë të rinj, ndërsa në proces rekrutimi janë dhe

dyzet kadetë të tjerë. Por nuk do të ndalemi me kaq. Në

muajin shtator do të hapet konkursi për rekrutimin edhe të treqind ushtarëve të cilët do ta fillojnë trajnimin bazik në nëntor. Premtuam ngritje të kapaciteteve mbrojtëse dhe në këtë drejtim krahas pothuajse dyfishimit të numrit të përgjithshëm të ushtarakëve investuam që ushtria e Kosovës të ketë në arsenalin ushtarak sistemet më moderne të armatimit", ka shkruar Maqedonci në "Facebook". Ai ka thënë se si qeveri kanë tejkaluar numrin e

rekrutimeve dhe aktiviteteve zhvillimore të parapara në planin e zhvillimit të FSK-së. "Përveçse përmbushëm, tejkaluam numrin e rekrutimeve dhe aktiviteteve zhvillimore të parapara në Planin gjithëpërfshirës të tranzicionit. Jemi përpara në implementimin e planit e me vizion më të qartë se kurrë për të ardhmen e ushtrisë së Kosovës si pjesë e aleancës së madhe të NATO-s, dhe garantues të sovranitetit territorial të Kosovës", ka shkruar Maqedonci.

Klinaku për arratisjen e Ramadani: Dëshën ta kthejnë në paraburgim për ta ekstraduar në Serbi

PRISHTINË, 15 GUSHT - Ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVL-UÇK-së, Faton Klinaku, ka reaguar pasi ish-ushtari i UÇK-së, Blerim Ramadani, është arratisur nga burgimi shtëpiak në Maqedoni të Veriut. Ai ka bërë me dije se Ramadani është arratisur pasi drejtësia maqedonase kishte vendosur për rikthimin e tij në paraburgim me qëllim që të ekstradonte në Serbi.

Klinaku ka shkruar në "Facebook" se pushteti i ri në Maqedoni, i cili është ndihmuar nga Albin Kurti, po i përndjek veteranët e luftës së UÇK-së. "Pasi nga arresti shtëpiak vendosën që ta kthenin në paraburgim me qëllim ekstradimi në Serbi, Blerim Ramadani u arratis dhe bëri shumë mirë. Shteti artificial i Maqedonisë paska lëshuar fletarrest ndaj tij,

sepse do që të zbatojë urdhërat e Vuçiqit. Ky pushtet i ardhur në Maqedoni, e që fatkeqësisht në emër të ndryshimit u ndihmua nga Kurti, po i përndjek veteranët e luftës së UÇK-së. Por, le ta kuptojnë se nëse vazhdohet kjo politikë e përndjekjes së shqiptarëve, për çdo eskalim të situatës do të jenë përgjegjës", ka shkruar Klinaku.





PRESIDENTJA OSMANI PËRFSHIHET NË DEBATIN PËR HAPJEN E URËS SË IBRIT PËR LËVIZJEN E AUTOMJETEVE

Aleatët po kërkojnë që hapja e urës së Ibrit të jetë e përhershme, jo e çastit

Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Kosova duhet të sigurohet që ura në veri të hapet në atë mënyrë që nuk nxit konflikt me aleatët e as prani të shtuar të misionit të NATO-s në vendin tonë. Ajo ka thënë se ShBA-ja asnjëherë nuk ka qenë kundër hapjes së urës së Ibrit. Në këtë kontekst, Osmani ka thënë se aleatët e Kosovës janë duke kërkuar që hapja e urës të jetë sukses i përhershëm, jo i çastit. Osmani ka thënë se Kosova nuk duhet ta pyesë Serbinë për hapjen e urës dhe se kjo çështje s'ka pse të diskutohet në dialogun e Brukselit. Sipas saj, deklaratat e fundit të BE-së në këtë temë janë "raciste"

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

Prishtinë, 15 gusht - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) asnjëherë nuk ka qenë kundër hapjes së urës së Ibrit. Gjatë vizitës në komunën e Vitisë, ajo ka thënë se aleatët e Kosovës po kërkojnë që hapja e urës të jetë sukses i përhershëm, jo sukses i çastit. Po sipas saj, ata duan që bashkërisht me institucionet e Kosovës ta gjejnë çastin e volitshëm për hapjen e urës. "Në takimet e mia në ShBA asnjëherë nuk është thënë se janë

kundër hapjes së urës, përkundrazi janë pro zbatimit të marrëveshjeve në Bruksel, të cilat kanë paraparë hapjen e urës. Po sikurse për çdo temë të sigurisë, kërkojnë dhe i luten Kosovës të ulemi bashkë, institucionet e Kosovës dhe aleatët tanë të sigurisë, dhe ta hartojnë së bashku planin e zbatimit, i cili merr parasysh vlerësimin e sigurisë edhe të Kosovës edhe të aleatëve tanë dhe ju siguroj se në shumicën e rasteve ato janë identike. Dhe në bazë të këtyre vlerësimeve të përbashkëta, të përzgjidhet momenti më i volitshëm në mënyrë që çështja e urës dhe hapja e saj të jetë sukses i përhershëm, jo sukses i

momentit", ka thënë Osmani. Më tutje ajo ka bërë me dije se Kosova duhet të sigurohet që kur ajo urë të hapet, të mbetet e tillë. Sipas saj, nuk është në interes të Kosovës të ndodhë një konflikt në mes të Policisë së Kosovës dhe ushtarëve amerikanë. "Ajo urë nuk është dashur të mbyllet kurrë. Ajo urë është mbyllur për arsye politike. Ura duhet të hapet, por duhet të sigurohemi që kur të hapet, të mbetet e hapur, e jo kur të hapet të nxitë prani të NATO-s më të madhe në të. A është në interes të Kosovës të shohim konflikt në mes të policisë dhe ushtarit amerikan? Nuk besoj që ka shqiptar në tokë që pajtohet me të. Duhet të sigurohemi që

kjo të mos ndodhë. Nuk ka arsye që të kemi konflikte me aleatët tanë. Ata na kanë shpëtuar. Natyrisht, edhe për shkak të sakrificës së popullit tonë, ata janë me ne ta mbrojmë sovranitetin tonë. Urat kur të hapen janë të hapura", ka vlerësuar Osmani.

Presidentja Osmani ka theksuar se paqja dhe siguria janë çështje globale, assesi individuale. "Në çdo vend të botës ku Amerika apo NATO kanë rol në mirëmbajtjen e sigurisë, nga shtetet baltike e deri te Islanda, e deri te shtetet në Paqësor, sovraniteti dhe paqja mirëmbahen nga ato vende dhe Amerika. Të gjitha ato vende konsultohen dhe koordinohen me partnerët e tyre të sigurisë. Nuk është asgjë e jashtëzakonshme, dhe nuk dallon nga mënyra se si funksionojnë shtetet baltike. Ka forca edhe në Rumani dhe Poloni. Paqja e siguria janë çështje globale, jo individuale, jo vetëm e jona. Paqja dhe siguria në Kosovë nuk e afektojnë vetëm

Kosovën, por paqen dhe sigurinë në suaza shumë më të gjera, në veçanti në rastin tonë kur e dimë historinë, e mbajmë në mend. 1999 nuk është para dy shekujsh. Është para dy dekadave", ka vlerësuar ajo.

Osmani para gazetarëve ka thënë se Kosova e gëzon lirinë falë mbështetjes së aleatëve. "Sot e gëzojmë këtë paqe sepse kemi vepruar me aleatë. Në takimet e mia në Amerikë asnjëherë nuk është thënë se janë kundër hapjes së Urës. Janë pro zbatimit të marrëveshjeve në Bruksel që kanë paraparë hapjen e urës. Për çdo temë të sigurisë, kërkojnë dhe i luten të Kosovës që të ulemi bashkë dhe ta hartojmë bashkë planin e zbatimit i cili merr parasysh vlerësimet e sigurisë edhe të Kosovës edhe të aleatëve tanë, në shumicën e rasteve ato janë të njëjta. Në bazë të vlerësimeve të përbashkëta, të përzgjidhet momenti më i volitshëm në mënyrë që çështja e urës të jetë sukses i përhershëm, jo sukses i momentit", ka thënë Osmani.

Kurti i ofron bashkëpunim shifes së zyrës së KE-së në Kosovë

PRISHTINË, 15 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka mirëpritur të enjten në takim shifen e Zyrës së Këshillit të Evropës (KE) në Kosovë, Mary Ann Hennessey. Në këtë takim të parë të tyre, kryeministri Kurti ka theksuar bashkëpunimin e mirë me Zyrën e Këshillit të

Evropës në Kosovë dhe e ka falënderuar për bashkëpunimin e ngushtë për avancimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe për promovimin e të drejtave të njeriut. Ai e ka njoftuar Hennessey për progresin gjatë qeverisjes për forcimin e demokracisë dhe sundimin e ligjit që është

vlerësuar nga indekset ndërkombëtare, politikat e punësimit dhe të mirëqenies nga të cilat kanë përfituar të gjithë qytetarët pa dallim. “Së bashku diskutuan për projektet aktuale që Zyra e Këshillit të Evropës po zbaton në Kosovë dhe mundësitë e reja të bashkëpunimit”, ka njoftuar zyra e kryeministrit.



Mashtrimi është boshti kurrizor i politikës së Kurtit



Shkruan: Avni ARIFI

Logjika e pushtetit se opozita po gëzohet që po konfrontohet qeveria me KFOR-in apo logjika se opozita apo një pjesë e shoqërisë nuk i gëzohet hapjes së urës është logjikë shumë e poshtër që ky pushtet po mundohet me implantuar në trurin e shpërlarë të

votuesve të vet.

Asnjë njeri normal nuk i gëzohet konfrontimit me aleatët dhe s'ka njeri normal që nuk e donë kthimin e normalitetit në veri e në këtë rast hapjes së urës. Ndaluni pak e mendoni. A s'po e shihni sa jeni të mashtuar? Jeni të mashtuar nga ky pushtet me premtimet prej: bashkimit kombëtar, prej zhvillimit

ekonomik, prej pagave të administratës publike, prej pensioneve që nuk janë rritë që 6 vjet e 4 muaj, prej çmimit të energjisë dy herë të shtrenjtuar kurse ky ka pas premtuar lirim te saj. Ju ka mashtuar për korrupsion e janë korruptuar deri në fyt me tenderë një burimor dhe kontrata t klasifikuar, ka mashtuar

familjarët e të pagjeturve se nuk do të bëjë dialog me Serbinë pa u gjetur të pagjeturit, mashtron edhe sot se ka zvogëlim varfërie e ju mashtron ner sy për vendet e punës që gjoja i ka krijuar a në fakt rreth 200.000 veta i kanë braktisë trojet e Kosovës në katër vitet e fundit. I frymëzuar nga sukseset e mashtimit tani po ju mashtron

edhe për rrugën Tetovë-Prizren e kjo rrugë nuk bëhet pa marrëveshje me Maqedoninë e Veriut. Marrëveshje nuk ka nga Qeveria e re e Maqedonisë pavarësisht ndihmës që Kurti dha që Mickovski me shokë t'i fitojë zgjedhjet. Prej ditës së parë që ka ardhur kjo qeveri mashtrimi ka qenë boshti kurrizor i politikës së Kurtit.

Osmani i përgjigjet zëdhënësit të BE-së: Deklaratat e tij janë raciste, nuk diskutohet ura e Ibrit në Bruksel

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka reaguar zëdhënësit të Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, për deklaratat e tij rreth çështjes së hapjes së urës së Ibrit. Osmani ka thënë se deklaratat e tij janë raciste dhe nuk meritojnë

vëmendje dhe se çështja e urës së Ibrit nuk duhet të diskutohet në Bruksel. “Deklaratat e zëdhënësit të BE-së janë raciste, as nuk meritojnë më shumë vëmendje. Jam deklaruar në raport me ato deklarata raciste. Nuk ka asnjë arsye dhe kundërshtoj në çdo mënyrë diskutimin e çështjes së hapjes së urës në Bruksel. Nuk kemi çka e pyesim Serbinë, njëjtë sikur zëdhënësi nga Sllovakia që nuk e pyet asnjë shtet fqinj kur e kalon urën e vet. Nuk pyetet

Serbia për urën tonë. Dialog nuk do të duhet të pranonte askush për këtë temë. Dialogu me shpëtimtarët tanë jo vetëm që është i nevojshëm, po është në interesin tonë, mbi të gjitha. I lus qytetarët tanë, në situatën kur në botë aleatët tanë po merren me lloj-lloj konfliktesh dhe po shohim vuajtjet njerëzore të konflikteve, të punojmë me njerëzit që gjithmonë kanë qenë në krahun tonë”, ka thënë presidentja Osmani



Osmani flet për datën e zgjedhjeve: Nuk ka dallim një javë më shumë a më pak

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka folur në lidhje me datën e zgjedhjeve, duke thënë se kanë kohë deri nesër në fund të orarit për

vlerësime shtesë nga opozita. Osmani ka thënë se sot (e premte) do ta dëgjojë vlerësimin e kabinetit pasi, sipas saj, ata i kanë të gjitha

çështjet e ngritura nga partitë. “Do të kemi kohë deri nesër (e premte) në fund të orarit nëse kanë vlerësime shtesë. Më pas,

nesër, pasi të përfundojë orari, do t'i dëgjoj vlerësimet e kabinetit tim. Ata i kanë të gjitha çështjet e ngritura nga partitë. Është

diskrecion i presidentit. Nuk ka dallim një javë më shumë, më pak. Nuk bën diferencë të madhe”, ka thënë Osmani.

KQZ-ja miraton Rregulloren për fushatën zgjedhore, monitorimin dhe deklarimin financiar

PRISHTINË, 15 GUSHT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar të enjten Rregulloren zgjedhore për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin dhe deklarimin financiar. Kjo rregullore është votuar me 8 vota për, ndërsa është përditësuar neni 7 i saj, për

materialët e fushatës së zgjedhjeve, ku është shtuar se do të “ndalohet vendosja e materialit nga subjektet politike në ndërtesa apo objekte të banimit pa pëlqimin e banorëve dhe pa kontraktim. Rregullorja është pjesë e akteve nënligjore të harmonizuara me

Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, i miratuar nga Kuvendi në vitin 2023, e cila përcakton rregullat dhe monitorimin e fushatës së zgjedhjeve, procedurat për kufizimin e shpenzimeve dhe deklarimin financiar për fushatën e zgjedhjeve.



IKShPK-ja fton qytetarët për kujdes nga “Lija e Majmunit”

PRISHTINË, 15 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se po e përcjellin me vëmendje epidemiologjinë “Mpox” (dikur të quajtur si “Lija e Majmunëve”), pas shpalljes emergjencë globale për shëndetin publik nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) për herë të dytë brenda dy vjetëve. Sipas IKShPK-së, në Republikën e Kosovës nuk është raportuar asnjë rast i dyshimtë sa i përket kësaj sëmundje dhe se nuk ka vend për panik, por për kujdes. “MSh/IKShPK njofton qytetarët e Republikës së Kosovës se po e përcjell me vëmendje epidemiologjinë e ‘Mpox’ që nga paraqitja e rasteve të para sivjet në kontinentin e Afrikës. Në



Republikën e Kosovës, nuk është raportuar asnjë rast i dyshimtë, sa i përket ‘Mpox’ dhe se nuk ka vend për panik,

por për kujdes. Jemi në komunikim të vazhdueshëm me OBSh-në dhe ECDC-në, për vlerësimin e

rrezikshmërisë dhe rekomandimeve për masat që duhet ndërmarrë për sëmundjen në fjalë. Në laboratorët e IKShPK-së janë në dispozicion reagensët për testimin e rasteve të dyshimta! IKShPK-ja po monitoron situatën epidemiologjike në bashkëpunim me ShSKUK-në dhe konform situatës epidemiologjike në rajon dhe në botë, do të dal me njoftime të reja”, ka njoftuar IKShPK-ja. Po ashtu, IKShPK-ja u ka rekomanduar profesionistëve shëndetësorë që ta rrisin vëmendjen për simptomat e sëmundjes, ndërsa qytetarët i ka këshilluar të lajmërohen te mjeku nëse kanë dyshime apo simptoma të sëmundjes. “Profesionistët shëndetësorë rekomandohet ta rrisin

vëmendjen për simptomat e sëmundjes, ndërsa qytetarët këshillohen të lajmërohen te mjeku nëse kanë dyshime apo simptoma të sëmundjes”, ka njoftuar IKShPK-ja. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) më 14 gusht 2024 ka shpallur “Mpox” emergjencë globale për shëndetin publik për herë të dytë brenda dy vjetëve. OBSh-ja e ka marrë këtë vendim pas përhapjes së virusit në Republikën Demokratike të Kongos, si dhe në vendet fqinje, sikurse në Burundi, Kenia, Ruandë dhe Ugandë. Qendra për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve në Afrikë ka thënë se vetëm këtë vit kontinenti i ka regjistruar 1 000 raste të infektimit të ‘Mpox’ dhe 517 vdekje.

Komuna e Prishtinës paraqet programin e mësimit gjithëditor: Përmirëson cilësinë në arsim



PRISHTINË, 15 GUSHT - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me drejtoreshën e Arsimit, Jehona Lushaku-Sadriu, kanë paraqitur programin e ri të mësimit gjithëditor në pesë shkollat e kryeqytetit. Në konferencë për medie është thënë se qëllimi i këtij programi është përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe avancimi i aftësive të fëmijëve përmes aktiviteteve jashtëkurrikulare. Shkollat e kryeqytetit do ta fillojnë mësimin tërëditor nga shtatori i këtij viti janë: “Faik Konica”, “Xhemail Mustafa”,

shkolla “Model”, shkolla “E Gjellbër” dhe ajo “Nazim Gafurri”. Kryetari Rama ka thënë se kjo do të ketë ndikim edhe te prindërit, pasi nuk do të kenë nevojë t’i marrin fëmijët në mesditë. “Mbi të gjitha, do të ketë më pak stres të prindërit sepse nuk kanë nevojë të shkojnë t’i marrin fëmijët në shkollë. Prindërit mund të fokusohen diku tjetër dhe jo të shkojnë t’i marrin në mes të ditës. Mësimi tërëditor i bën më të përmbushur edhe prindërit edhe fëmijët”, ka thënë Rama. Ndërsa drejtoresha e Arsimit,

Jeohona Lushaku-Sadriu, ka thënë se qëllimi i këtij programi është ngritja e cilësisë në arsim dhe shndërrimi në model për komunat e tjera. “Qëllimi është ngritja e cilësisë së arsimit dhe të jetë edhe model në komunat e tjera. Ka edhe shtete që e praktikojnë mësimin tërëditor nga 1 deri 5. Kemi siguruar mjete dhe do t’u mundësojmë që korrikula bazë të realizohet në mënyrë më kreative. Kemi marrë sportistë në mënyrë që ta realizojmë në mënyrë profesionale lëndën e sportit”, ka deklaruar Lushaku-Sadriu.

Hamza: Mitrovica s’është vetëm minierë e arit, por edhe e kulturës dhe e emancipimit

MITROVICË, 15 GUSHT - Në qytetin e Mitrovicës është hapur festivali i artit “Green Fest”. Me këtë rast, kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka vlerësuar se Mitrovica nuk është vetëm minierë e arit. Ai ka shkruar në “Facebook” se ky qytet është edhe minierë e kulturës, emancipimit, muzikës dhe bashkëjetesës ndëretnike. “Si

freski kulturore në këto ditë të nxehta, mbrëmë në Mitrovicë nisi ‘Green Fest’. Mitrovica nuk është vetëm minierë e arit, por edhe e kulturës, emancipimit, muzikës dhe bashkëjetesës ndëretnike. Thesari ynë më i madh janë njerëzit, të cilët krijuan traditë dhe vlera të artit bashkëkohor. Arti përbën edhe një segment të rëndësishëm në planin tim për zhvillimin e

industrive kreative, që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe punësimin e të rinjve. Në ‘Green Fest’ do të performojnë artistë të shumtë katër ditë me radhë. Jam krenar për përkrahjen e këtij festivali, por edhe një numri rekord të ngjarjeve kulturore. Ejani dhe shijoni mikpritjen mitrovicase!”, ka shkruar Hamza.



Policia arreston një të dyshuar për kontrabandë të mallrave nga Serbia

PRISHTINË, 15 GUSHT - Policia e Kosovës ka njoftuar të enjten se ka arrestuar një shtetas serb të dyshuar për kontrabandë të mallrave nga Serbia në Kosovë. Në një komunikatë për medie, policia ka bërë me dije se zyrtarët policorë dhe doganorë të Kosovës kishin vërejtur dy automjete me targa serbe duke u futur jashtëligjshëm nga fshati Dobrosinë në jug të Serbisë në

qytetin juglindor të Kosovës, Gjilan, të enjten pasdite. Sipas policisë, i kanë paralajmëruar njësitet e tjera doganore në Graçanicë për mbërritjen e dy automjeteve të dyshuara, ku të dyshuarit nuk i kanë zbatuar urdhrat e zyrtarëve për t'u ndalur dhe, derisa njëri prej tyre u kap, tjetri ia doli të arratiset. “Dy drejtuesit e automjeteve nuk kanë zbatuar urdhrat e

zyrtarëve doganorë që ishin me uniformë dhe veturë zyrtare. Është arritur të ndalet vetëm njëra veturë me drejtues të dyshuarin V. B., i moshës 36-vjeçar, shtetas i Serbisë. Kurse automjeti tjetër me drejtues të dyshuarin F. M. ka arritur të ikë në drejtim të panjohur duke shkaktuar disa aksidente”, ka njoftuar policia. Shtëpia e të arrestuarit në lagjen

Hajvalia në Prishtinë është kontrolluar nga autoritetet e sigurisë, të cilat kanë gjetur mall pajisje elektrike me origjinë serbe, që dyshohet të jetë futur në Kosovë përmes kontrabandës, ka treguar policia. I dyshuari i arrestuar do të mbahet në paraburgim për 48 orë. Në Kosovë është i ndaluar importi i mallrave nga Serbia. Në



korrik 2023 Qeveria e Kosovës kishte marrë vendim për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia për arsye “sigurie”, kur tre policë të Kosovës ishin arrestuar nga policia serbe.

Vendimi për subvencionimin e teksteve shkollë, PDK-ja akuzon ministren Nagavci për zhvatje të buxhetit të shtetit

PRISHTINË, 15 GUSHT - Anëtarët e Komisionit Hetimor për subvencionimin e teksteve shkollë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ardian Kastrati dhe Bekim Haxhiu, kanë kundërshtuar vendimin e qeverisë për subvencionimin e teksteve shkollë. Sipas tyre, qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti po përdor “dhunë psikike” te prindërit me këtë vendim. Nën kryetari i këtij komisioni, Ardian Kastrati, e ka akuzuar ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci, për keqpërdorim, derisa ka thënë se ajo është e afërt edhe me shtëpinë botuese “Albas” duke i dhënë tenderë. “Kemi të bëjmë me një pushtet të përgjegjshëm që merr vendim të papërgjegjshëm. Nagavci ka shkelur ligjin për subvencionimin e teksteve shkollë. Kjo është një shkelje e rëndë dhe dëshirojmë ta tërheqim vëmendje në këtë trajektore që themi është një shkelje ligjore. E kemi zënë

Nagavcin duke vjedhur vota. Në të kaluarën Nagavci është paguar nga shtëpia botuese ‘Albas’ dhe pikërisht kjo kompani i ka shumëfishuar tenderët e teksteve shkollë. Ju e dini se çfarë kaosi ka shkaktuar vendimi për subvencionimin e teksteve shkollë. Në kohën kur kemi qenë në pushtet më 20 gusht tekstet kanë qenë veçse të gatshme, ndërsa tash ka raste që është përfunduar viti shkollor pa tekste shkollë”, ka thënë Kastrati, duke shtuar se për këtë gjendje edhe kryeministri Albin Kurti është fajtor. “Nagavci ka përdorur dhunë psikike ndaj prindërve për t'u pajisur me libra. Përgjegjës është Albin Kurti. Gruaja e Kurtit a do të kishte pritur në 30 gradë nëpër librari? Vendimet e tij prekin drejtpërdrejt qytetarin. I ka goditur edhe në buxhet prindërit dhe jorastësisht është dështuar që veprimet e Kurtit t'i përjetojë familja e Albin Kurtit. Vetë Nagavci ka deklaruar se vitin e



kaluar janë shpenzuar 4 milionë e 800 mijë. Këta me ndërrimin e subvencionimit kanë shpenzuar 11.6 milionë euro, kurse janë 100 mijë nxënës më pak. Ku kanë shkuar të gjitha këto para? Kanë humbur miliona dhe po

humbasin shumë nxënës dhe prindërit”, është shprehur Kastrati. Ndërsa anëtar i tjetër i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka thënë se qeveria ka zhvatur buxhetin e shtetit me këto subvencione.

Po sipas tij, fjala subvencionim nuk njihet në Ligjin e Arsimit. “Ndiejmë keqardhje që Nagavci është bërë recidiviste. Nëse e lexoni ligjin e arsimit e shihni që fjala subvencionim nuk ekziston, por kjo është blerje e librave. Kjo është shkelje ligjore dhe keqpërdorim i buxhetit. Nëse të gjithë nxënësit do të subvencionohen, atëherë i bie vetëm nga klasa e parë deri në të pestën, 9 milionë e 531 mijë euro, kurse klasat e ciklit më të lartë prej 10 milionë e 592 mijë që i bie në total të gjithë nxënësit do të paguajnë 20 milionë euro. Kjo është keqpërdorim dhe zhvatje e shtetit. E kemi vërejtur diferencën e këtij profiti që nuk kushtojnë njëjtë librat si ata të klasës së parë dhe ata në klasën e pestë dhe kjo bën dëm për prindërit. Shumica e librarive vitin e fundit janë futur në TVSh, duke ndikuar në rritjen e çmimit të kostos së buxhetit të shtetit. Ende vazhdon zhvatja e buxhetit të shtetit”, ka thënë Haxhiu.

Suspendimi i komandantit të policisë në Skenderaj, Berisha: Në çka u mbështet ky vendim, se mua nuk po ma kap logjika?

PRISHTINË, 15 GUSHT - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Bekë Berisha, ka reaguar në lidhje me suspendimin e komandantit të Policisë së Kosovës në Skenderaj, pasi ky i fundit ka shkuar për ngushëllim te familja e Faton Hajrizit. Berisha përmes një video në “Facebook” ka thënë se shteti serb i ka shpërblyer policët që e kanë

vrarë Faton Hajrizin por që, sipas tij, kanë pasur mundësi edhe ta arrestojnë. “Shteti serb i ka shpërblyer policët që e kanë vrarë qytetarin e Kosovës, Faton Hajrizin, edhe pse kanë mundur mos ta vrasin sepse, sipas rregullave, është dashur ta arrestojnë, sepse i kanë pasur mundësitë. Ndërkohë Policia e Kosovës e ka suspenduar një komandant të policisë vetëm



pse ka shkuar në ngushëllime të një familje fisnike dhe e ndershme”, ka thënë Berisha. Më tutje, Berisha ka kërkuar shpjegim nga Inspektorati Policor dhe nga Policia e Kosovës se në çfarë e kanë mbështetur vendimin për suspendimin e komandantit pasi. “A mund të më tregojë dikush prej Inspektoratit dhe prej Policisë,

çfarë krimi ka bërë një komandant që e ka bërë një veprim krejt njerëzor? A mund të më tregojë dikush se në çka e kanë mbështetur vendimin për suspendimin, se mua nuk po ma kap logjika, apo kemi filluar edhe ne tashti ta internojmë edhe familjen sikur në kohën e komunizmit?”, ka përfunduar Berisha.

KShC-ja akrediton Fakultetin e Bujqësisë dhe programet në Fakultetin e Arteve

PRISHTINË, 15 GUSHT - Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ka akredituar Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës. Lajmin e ka dhënë ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit, Arbërie Nagavci, e cila ka thënë se, përveç këtij fakulteti, janë

akredituar edhe programe të fakultetit të arteve. Nagavci ka thënë se i mbetet Universitetit të Prishtinës t'i zgjidhë përfundimisht problemet infrastrukturore. “Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka vazhduar akreditimin për një vit për programet e arteve në Universitetin e Prishtinës dhe

akreditimin për një vit për programet e studimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës në Universitetin e Prishtinës. Kjo nënkupton që sapo të jenë gati do t'i bëjnë të gjitha përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri akademik si dhe shpalljen e konkurseve për studentë konform legjislacionit

në fuqi. Në fillim të këtij muaji, duke u bazuar në Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), kam nënshkruar Udhëzimin Administrativ për masa afirmative për programet e komuniteteve joshumicë dhe programet e arteve. Universitetit të Prishtinës i mbetet t'i zgjidhë



përfundimisht problemet infrastrukturore të trashëguara me vite. Suksese të gjithë studentëve!”, ka njoftuar Nagavci.

Paqartësi për investimet nga diaspora në Kosovë

PRISHTINË, 15 GUSHT - Pas 35 vjetëve në Zvicër, Zekrija Ramushi ka vendosur të kthehej në Kosovë për më shumë sesa vetëm një pushim disaditor. Në vitin 2021 ai ka investuar në hapjen e një kompanie të taksive në Prishtinë dhe ka thënë se as që e kishte paramenduar se me çfarë lloj barrierash mund të përballej në biznesin e tij. Pasi kishte investuar rreth pesë milionë euro në kompaninë me vetura elektrike të llojit "Tesla" dhe ka punësuar 150 punëtorë me pagë mesatare prej 800 eurosh në muaj, ai kishte planifikuar ta zgjeronte biznesin edhe në Ferizaj. Por, tash e dy vjet ai ka thënë se nuk ka arritur ta finalizojë këtë plan, pavarësisht se ka pasur takime me zyrtarë komunalë për mundësi të investimit.

Në maj të këtij viti, pasi ka thënë se ka investuar mbi 1.5 milion euro për 12 vetura elektrike dhe punësimin e 40 punëtorëve, ai ka kërkuar të pajiset me leje për ta nisur punën edhe në Ferizaj. "Për të marrë leje të punës duhet të presësh me muaj. Duhet me të njohur. Ky është korrupsion pasiv. Kjo është dekurajuese. Unë e kam vullnetin, e kam dëshirën (të investoj në Kosovë). Por, dikur lodhem. Nuk është mirë gjithmonë të ketë barriera", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Në komunën e Ferizajt janë në dijeni lidhur me rastin e Ramushit. Në një deklaratë për "REL"-in, nga kjo komunë kanë thënë se i kanë pezulluar të gjitha kërkesat për leje të funksionimit si taksi. "Komuna është në fazën përfundimtare të fizibilitetit dhe modalitetit të taksive pasi ka numër të madh të tyre. Gjithashtu, jemi në përfundim të procedurave të transportit publik urban, i cili është duke u bërë për herë të parë në komunën e Ferizajt", kanë thënë nga komuna e Ferizajt.

Ramushi është shprehur i zhgënjyer për barrierat që ka pasur deri më tani në investimet



në Kosovë. Por, një tjetër biznesmen, i cili ka vendosur ta lë Zvicrën për të investuar në Kosovë, Nazmi Mehmetaj, ka thënë se ka pasur përvojë më pozitive.

Pasi ka jetuar në Zvicër që nga viti 1992, Mehmetaj është kthyer në Pejë në vitin 2015 për ta themeluar kompaninë "GreenHouse", që merret me përpunimin e drurit për shtëpi të parafabrikuara. Tani ai është duke planifikuar ta zgjerojë biznesin dhe e cilëson Kosovën vend të mirë për investime. "Unë nuk kam pasur probleme. Ia vlen të investohet (në Kosovë). E ftoj diasporën të hapë biznese sepse është lehtë të operohet dhe ia vlen meqë ka përfitime materiale", ka thënë Mehmetaj për "Radion Evropa e Lirë". Megjithatë, Mehmetaj ka thënë se përvoja e tij mund të mos jetë e njëjtë si e bizneseve të tjera ku qytetarë nga diaspora kanë investuar. "Po flas për rastin tonë. Ne eksportojmë, për të tjerët nuk e di. Kompania jonë prodhon dhe eksporton. Nuk kemi shumë punë me institucionet e tjera", ka thënë ai.

Mehmetaj ka thënë se prodhimet

i shet në shtete evropiane, si Gjermani, Francë, Zvicër, Holandë e Austri.

Lirim Krasniqi, nga organizata "Germin" që merret me çështje të diasporës, beson se Kosova nuk është vend shumë tërheqës për investime nga diaspora. "Legjislacioni në Kosovë i trajton (investitorët nga diaspora) në mënyrë të barabartë dhe të njëjtë sikur çdo investitor tjetër të huaj. Pra, nuk ka një qasje preferenciale karshi investitorëve dhe komunitetit të biznesit të diasporës", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Më 16 korrik të këtij viti Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore dhe Agjencinë e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), i ka bërë thirrje diasporës të investojë në Kosovë përmes projektit "Dritarja për Investime të Diasporës".

Përmes këtij projekti, që do të zgjasë pesë vjet, mërgata do ta ketë më të lehtë aplikimin për kredi për investime në Kosovë. Ndërmarrjet e reja nga diaspora dhe ato që janë themeluar deri në tre vjet më parë mund të aplikojnë për kredi deri në tre milionë euro në bankat

komerciale në Kosovë. Aplikimet janë të hapura nga 9 gushti i këtij viti deri më 31 korrik të vitit të ardhshëm.

Investitorët parashihet ta mbulojnë 20 për qind të investimit, kurse Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të ofrojë garanci deri në dy milionë euro, thuhet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Për promovimin dhe mbështetjen e investimeve në Kosovë luan rol kyç Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA). Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të KIESA-s, Zef Dedaj, ka thënë se ata nuk kanë të dhëna specifike për investimet nga diaspora.

Të dhënat që ata kanë nga Banka Qendrore e Kosovës, tregojnë vetëm për sektorët në të cilët investohet dhe nga cili vend vjen investitori.

Krasniqi nga organizata "Germin" këtë e ka quajtur absurde. "Politikat dhe mekanizmat që janë ndërmarrë nga qeveria nuk janë bazuar në evidencë dhe fakte. As nisma e fundit nuk është rezultat i një analize të të dhënave se sa janë investimet, përfitimet, cilët janë sektorët dhe preferencat e

diasporës", ka thënë ai.

Megjithatë, Krasniqi ka treguar se, në bazë të një hulumtimi të publikuar vitin e kaluar, 500 biznese nga diaspora janë shprehur të gatshme që në të ardhmen të investojnë në Kosovë. Ndër sfidat që ata kanë theksuar, është mungesa e informacionit për potencialin e investimeve në Kosovë. Por, Dedaj ka thënë se KIESA ka realizuar forume në disa vende, si Gjermani, Belgjikë, Angli, Kanada, Austri, Luksemburg dhe Zvicër, me qëllim të informimit rreth mundësive, procedurave teknike, si dhe me legjislacionin në fuqi.

Në kuadër të këtyre forumeve, ka theksuar ai, janë realizuar takime me bizneset e diasporës që kanë shprehur interesim për sektorin e përpunimit të metaleve, turizmit, teknologjisë së informacionit, energjisë së ripërtërishme etj.

Sipas të dhënave preliminare nga regjistrimi i sivjetmë i popullsisë në Kosovë, rreth 600 mijë qytetarë të Kosovës jetojnë jashtë vendit. Numri i saktë pritet të bëhet publik nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në fund të këtij viti.

Diaspora e Kosovës luan rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit përmes remitencave, investimeve në patundshmëri dhe shpenzimeve që bën gjatë pushimeve në Kosovë.

Nga muaji janar deri në qershor të këtij viti remitencat e mërgimtarëve në Kosovë arritën vlerën mbi 632 milionë euro. Dërgesat financiare kaluan shifrën prej 1.3 miliard eurosh vitin e kaluar, kur i gjithë buxheti i Kosovës ishte 3.2 miliardë euro.

Vlera e investimeve të huaja në Kosovë, që përfshin edhe investimet e diasporës, në periudhën janar-maj të këtij viti ka arritur në 350 milionë euro, derisa vitin e kaluar kjo shifër ishte rreth 850 milionë euro. Pjesa më e madhe e investimeve janë nga Gjermania, Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mbi 18 milionë euro për sheshin "Xhorxh Bush", komuna e Prishtinës nis procedurat

PRISHTINË, 15 GUSHT - 18 milionë e 400 mijë euro është vlera e tenderit që ka hapur komuna e Prishtinës për ndërtimin e sheshit "Xhorxh Bush". Tashmë komuna e udhëhequr nga kryetari Përparim Rama ka dorëzuar njoftimin paraprak për kontratë.

Lloji i procedurës është i hapur dhe kriteri për dhënien e kontratës është "tenderi ekonomikisht më i favorshëm". Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve është deri më 6

shtator deri në orën 14:00.

Sipas dosjes së tenderit, punimet për ndërtimin e këtij sheshi duhet të përfundojnë brenda 540 ditëve të punës. Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të punëve të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë jo më pak se 27 milionë e 500 mijë euro.

Përveç kësaj dëshmie, operatorit ekonomik duhet t'i

plotësojë edhe kërkesat e tjera që janë përcaktuar nga komuna. Ndërsa në dosjen e tenderit nuk janë dhënë specifikimet teknike të detyrueshme për shkak të vëllimit të madh të projektit. "Projektin mund ta tërhiqni përmes CD-së në zyrën e prokurimit nr. 209. Për shkak të vëllimit të madh të projektit nuk kemi mundur ta ngarkojmë në sistem të E-prokurimit", është thënë në dosjen e tenderit.



ANALIZA: Ç’do të ndodhë pas sulmit të Kievit në territorin rus?

Ndërsa forcat ukrainase po vazhdojnë operacionin sulmues më në thellësi të Rusisë, po lindin pyetje se çfarë planifikon të bëjë Kievi me territorin rus që ka marrë nën kontroll.

Siç njofton korrespondentja e Zërit të Amerikës, Anna Chernikova, ekspertë të sigurisë e shohin operacionin e Ukrainës si një përpjekje për të tërhequr trupat ruse nga vijat e frontit, ndërsa tokën e pushtuar si mjet në negociatat e mundshme për paqe. Banorët e qytetit Sumy, vetëm 30 kilometra nga kufiri i Ukrainës me Rusinë, rrethohen me shenja lufte. Për Svitlanën dhe të tjerët këtu, kapja e territorit rus nga Ukraina në rajonin kufitar Kursk, ishte një befasi dhe shenjë se lufta mund të jetë një hap më afër fundit.

“Në fund të fundit, kjo luftë duhet të përfundojë disi. Nuk është e drejtë, sepse sulmet po vinin

vetëm nga një drejtim dhe nuk është luftë kur është e njëanshme. Duhet të përgjigjemi në mënyrë që të përfundojë më shpejt”, thotë ajo.

Sumy ishte një nga qytetet e para të Ukrainës që u përball me sulmin rus më 2022.

Dy vjet më vonë, ky qytet është përdorur si bazë për sulmin e befasishtëm të Ukrainës në Rusi. Banorët thonë se sulmet ruse me raketa janë ashpërsuar dhe intensifikuar nga java e kaluar, kur Ukraina nisi operacionin e saj sulmues në Kursk të Rusisë.

“Mendoj se situata është përshkallëzuar. Rusët po përgjigjen, janë të zemëruar”, thotë Tatiana, banore e qytetit Sumy.

Zyrtarët thonë se synim i Ukrainës nuk është pushtimi i përhershëm i territorit rus. Presidenti Volodymyr Zelenskyy thotë se kjo po bëhet për të mbrojtur popullin



ukrainas dhe përfundimin e luftës.

“Duke shkatërruar praninë ushtarake ruse në zonat kufitare, paqja dhe siguria për shtetin tonë janë më afër”, thotë ai.

Ekspertë të sigurisë e shohin operacionin e Ukrainës si përpjekje për të detyruar

tërheqjen e trupave ruse nga vija e frontit.

Ata e shohin tokën e pushtuar si një mjet në negociatat e mundshme për paqe.

“Siç tha Presidenti Biden, është një dilemë strategjike për Rusinë, Putinin. Përse? Sepse tani Putini ka dy opsione, të mbrojtë rajonin e

Kurskut në territorin e Rusisë, apo të vazhdojë operacionin sulmues në vijën e frontit lindor në Donbas të Ukrainës”, thotë Oleksandr Musienko nga Qendra për Studime Ushtarake dhe Ligjore.

Ai thotë se Ukraina po nxjerr në pah edhe dobësitë e Rusisë.

“Duke i treguar botës se nuk duhet të ketë frikë nga rusët. Ukraina duhet të lejohet të përdorë raketa me rreze të gjatë veprimi kundër objekteve të ushtrisë ruse në territorin e tyre”, thotë zoti Musienko.

Në Ukrainë, e gjithë vëmendja është tek zhvillimet e papritura në Kursk, sa larg mund të shkojë dhe si do ta ruajë Kievi kontrollin e territoreve ruse.

Kapja e territorit rus ka ndezur shpresat në Ukrainë se fundi i luftës është afër dhe se rezultati mund të jetë në favor të Kievit./VOA

E qeshura e Kamala Harris, arma e saj sekrete

Donald Trump nuk lodhet së denigruari rivalen e tij, kandidaten e demokratëve për presidente, Kamala Harris, zëvendëspresidentja aktuale e SHBA.

Ai tallet me të, si grua, si person me ngjyrë.

Ndjekësit e tij në internet bashkohen, duke përhapur meme ofenduese dhe video të rreme. Por Harris dhe ekipi i saj i fushatës i përballojnë këto sulme duke i mbajtur pasqyrën ekipit të Trump.

Shumë ndjekës në internet po merren me këtë rast, – veçanërisht në TikTok. Kanalet që më parë merreshin me personazhe të famshëm të showbizit e portretizojnë Kamala Harris si një ikonë të popit.

Në fokus është e qeshura e Kamal Harris, që qesh edhe për veten, që i le të kalojnë fushatat e sulmeve pa u trembur dhe sipas rastit edhe kundërsulmon. Kështu së fundmi ajo tha, se i njeh si prokurorë shkelësit e ligjit të të gjitha llojeve. “Kriminelë që keqtrajtojnë gratë, mashtrues, gënjeshtarë, që i përdorin rregullat për favoret e tyre. Më besoni unë i njoh tipa si Donald Trump.”

Ajo e nervozon vërtet Trump kur e quan “weird” – “të çuditshëm”, qesharak -dhe pastaj i kthehet seriozitetit të temave të fushatës zgjedhore. Me këtë taktikë ajo së bashku me Tim Walz, kandidatin për zëvendëspresident, jo me më pak humor po fiton pikë, thotë studiuesja e humorit, Eva Ullmann: “Fushata zgjedhore në SHBA nuk ka të bëjë sigurisht vetëm me humorin. Dyshja

Harris-Walz ka një linjë të qartë politike, mund të afirmohet dhe ka një status të lartë. Ata nuk janë kabaretistë, as nuk duan të shfaqen si të tillë, por humorit i tyre ka diçka shumë të ngrohtë, me këmbë në tokë, diçka tërheqëse, dhe kjo është shumë çarmatosëse.”

Ullmann thotë, se avantazhi i madh që të dy kanë ndaj Trumpit kur bëhet fjalë për humorin është “fakti që ata nuk shfaqen aspak të parespektueshëm. Pikërisht kjo duket se po i po i kthehet Trumpit dhe rrethit të tij si bumerang, sepse shoqëria thotë : ‘Jo, nuk kemi më nerva për këtë denigrim të vazhdueshëm, për nënçmim, urrejtje, jemi ngopur me këto, nuk e duam më këtë formë humorit.’”

Humori nuk është humbje e pushtetit

Recently Spotted Asteroid Set for Near Miss With Earth00:00/01:31 Eva Ullmann, autore e librit “Humori është çështje e shefit”, është e bindur se kultura e humorit dhe e qeshura po ndryshon. “Humori në pozitat e pushtetit ka qenë prej kohësh i lidhur me një formë agresive humorit si ajo formë që praktikon Trump. Por kjo nuk mjafton për të menaxhuar mirë punonjësit. Vetëdija se ka edhe humor që mund t’i bëjë të tjerët të duken mirë, që nuk i turpëron të tjerët, ky është në fakt një zhvillim i ri në postet e larta. Frika më e madhe për humor mes njerëzve në pozita pushteti është se mos nuk merren seriozisht, se bëhen qesharakë dhe shihen si klounë.

Frika nga e qeshura është arkaike

Kjo frikë është e rrënjësuar thellë në historinë njerëzore. Studiuesit e sjelljes njerëzore janë të bindur se e qeshura ka qenë në fillesë të komunikimit njerëzor – njerëzit parahistorikë kanë qeshur para se të mund të flisnin. Psikologu dhe studiuesi i së qeshurës, Michael Titze shpjegon se si, rreth 400.000 vjet më parë një e qeshur me shaka mund të kthehej gjithashtu në një kërcënim: “E qeshura jepte një ndjenjë afërsie, lidhjeje dhe të qenurit mirë brenda grupit. Por sapo përballeshin dy klane, për shembull për shkak të grindjes për zona gjuetie, e qeshura e të tjerëve mund të nënkuptonte gjithashtu: jemi mundur, ata po dominojnë dhe po na përqeshin”. Frika nga të bërit qesharak është diçka shumë arkaike – dhe çdo politikan sot ka frikë prej saj”.

E qeshura ka qenë e politizuar që në kohët antike. Filozofi grek Platoni, për shembull nuk ishte përkrahës u humorit, ai ishte i mendimit se e qeshura ishte e rrezikshme për shtetin. Sipas tij kushdo që i jepet kënaqësisë së të qeshurës nuk është më në gjendje të mendojë racionalisht dhe humbet fuqinë. Nga ana tjetër, nxënësit të tij Aristotelit i pëlqente të qeshte dhe ishte i mendimit se e qeshura i dallon njerëzit nga kafshët. Ndoshta historia botërore do të kishte qenë ndryshe, nëse Aristoteli do të ishte ndjekur si model. Por jo, kur erdhi krishtërimi, bashkë me të erdhi edhe një fe në të cilën



gëzimi dhe e qeshura nuk shiheshin me sy të mirë për një kohë të gjatë.

E qeshura në rajone të ndryshme të botës

Kjo ka ndryshuar gjatë shekujve e deri më sot, por frika shekullore e humbjes së pushtetit përmes lëshimit tek e qeshura – ekspertët e quajnë këtë frikë nga të përqeshurit si “gelotofobi” – është ende në mendjet e shumë njerëzve – në disa rajone të botës edhe më shumë se në vendet perëndimore. Në vitin 2009, një studim shumëkombësh në 73 vende i kryer nga Universiteti i Cyrihut zbuloi se në kultura të caktuara si në Lindjen e Mesme apo Azi, ku i kushtohet theksi i veçantë nderit dhe ruajtjes së fytyrës, e qeshura mund të perceptohet shumë ndryshe. “Të përqeshësh apo të tallesh mund të çojë në reagime të pabesueshme, madje mund të shkaktojë luftëra”, thotë Michael

Titze. “Kjo është arsyeja pse e qeshura në vetvete është shumë ambivalente”.

Po të kthehemi tek Kamala Harris: Sipas ekspertit Titze, ajo thjesht mund të qeshë me anët negative të të qeshurave të të tjerëve: “Ajo kritikohet dhe më pas fillon të qeshë me gjithë zemër, ashtu që të dobësojë kundërshtarët e saj”. Natyra gazmore e Kamala Harris është gjithashtu një lloj komunikimi. “Sipas motos: “Shiko si veprojnë unë dhe nëse dëshiron, eja bashkë me mua dhe pjesën tjetër e bëjmë bashkë”.

Kur dikush – si Harris – qesh me zë të lartë, truri lëshon neurotransmetues që përcjellin një ndjenjë të mirë. Jo më kot thuhet: “E qeshura është ilaçi më i mirë”.

Njerëzit e lumtur janë tërheqës. Megjithatë, studiuesi i të qeshurit Michael Titze e bën të qartë se e qeshura është gjenetike: “Nuk mund të mësosh humorin, nuk mund ta luash ose ta detyrosh, sepse atëherë duket e sforcurar. Potenciali individual i zhvillimit të humorit është i lindur.”/DW



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova mposhtet nga Franca në Botëror

Prishtinë, 15 gusht - Hendbollistët e Kombëtares U18 të Kosovës e kanë luajtur të enjten ndeshjen e dytë në Kampionatin Botëror në Chuzhou të Kinës. Përballë lojtareve tona ishte

Kombëtarja e Francës, një prej më cilësoreve në botë. Cilësia ishte në anën e francezeve që fituan me rezultat 44:16. Kjo gjeneratë e Francës vitin e kaluar e fitoi titullin e Evropës për

grupmoshën U17. Është prej favoriteve për ta fituar Botërorin në Kinë. Sara Gjergjaj i kishte katër gola nga gjashtë tentime për Kosovën. Katër gola nga shtatë tentime i realizoi Martina Bibaj, kurse

Andra Uglani i shënoi tri gola nga nëntë tentime. Të shtunën prej orës 8:00 Kosova luan ndaj Indisë. Është kjo ndeshja e fundit në fazën e parë grupore dhe rasti i madh për sukses.



Rrezikohet mosmbajtja e Lojërave Mesdhetare, Rama: Qeveria tentoi ta marrë organizimin e tyre



Prishtinë, 15 gusht - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka folur për rrezikun e mosmbajtjes së Lojërave Mesdhetare “Prishtina 2030”. Ai ka konfirmuar se Qeveria e Kosovës synoi ta marrë në dorë menaxhimin e këtyre lojërave. “Qeveria na ka thënë që po punon në një ligj të ri për Lojërat Mesdhetare. Unë kam pritur që ai ligj i ri për Lojërat Mesdhetare të mundësojë zhvillimin e shpejtë të infrastrukturës për Lojërat Mesdhetare. Ka qenë synim që të merret menaxhimi nga qeveria,

[por] këtë nuk e ka pranuar Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare”, ka deklaruar Rama në një konferencë për media. Ai e ka pranuar se 10 muaj kanë humbur pa u punuar si duhet për organizimin e këtyre lojërave, duke konfirmuar kështu edhe paralajmërimin që Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare i pati dhënë Kosovës. Mes të tjerash, në një përgjigje për qeverinë, Komiteti pati thënë se duhet të kompletohen sa më shpejt dokumentacionet e

kërkuara dhe se afati i fundit për ta bërë funksional Komitetin Organizativ të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030 është 8 shtatori i vitit 2024. “Tash jemi prapë në tavolinë. Shpresoj që shumë shpejt do ta shqyrtojmë këtë çështje. Kemi bërë planifikime dhe po vazhdojmë të punojmë. Për fat të keq kemi pasur 10 muaj të humbur, të cilët do të mund të shfrytëzoheshin shumë më konstruktivisht sesa që janë shfrytëzuar, por shpresoj që tash e tutje nuk do ta kemi atë problem”, ka shtuar Rama.

Kosova para Kinës nga vendet që performuan më së miri në ‘Paris 2024’ në xhudo

PRISHTINË, 15 GUSHT - Ishte paraqitja e tretë e Kosovës në një olimpiadë verore që kur u pranua në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar më 2014. Herën e parë Kosova në Rio 2016 u stolis me medalje të artë me Majlinda Kelmendin në xhudo. Për herë të dytë Kosova nga “Tokyo 2020” u kthye në shtëpi me dy të arta, sërish nga sporti i xhudos me Distria Krasniqin dhe Nora Gjakovën. Edhe nga Parisi 2024 ekipi olimpik i Kosovës u kthye me dy medalje, kësaj radhe një të argjendtë dhe një të bronzë. Sërish ishte sporti i xhudos ai që na bëri krenarë me Distria Krasniqin dhe Laura Fazliun. Duke u renditur e 73-ta prej 206 ekipeve në Lojërat Olimpikë “Paris 2024”, Kosova llogaritet si një ndër vendet që performuan më së miri në këtë garë – së paku në sportin e xhudos. Kështu ka vlerësuar Federata Ndërkombëtare e Xhudos (IJF). “Festojmë vendet që performuan më së miri dhe atletët e tyre të mrekullueshëm”, ka shkruar IJF, duke publikuar listën e vendeve që sivjet morën medalje olimpikë në xhudo. Kosova ka zënë vend në mesin e 15 vendeve që, sipas IJF-së, kanë treguar rezultatet më të mira në Paris 2024 në xhudo. E para në këtë listë është Japonia, e cila në sportin e xhudos ka



siguruar sivjet gjithsejtë 7 medalje – 3 të arta, një të argjendtë dhe 3 të bronzta. Pas saj janë vende të tjera të fuqishme, si Franca (vendi 3), Brazili (5), Italia (8), Kanadaja (10), kurse Kosova është në vendin e 14-t, një pozitë më lart se Gjermania, së cilës sporti i xhudos ia ka sjellë vetëm një medalje të bronzë, si dhe ka siguruar një vend të pestë dhe një të shtatë. Për dallim nga Gjermania, Kosova,

përpos dy medaljeve, nga Parisi u kthye edhe me një pozitë të pestë. Prapa Kosovës janë edhe vende të tjera të mëdha, si Spanja (20), Austria e Belgjika (të dyja në vendin 21), por edhe “superfuqia”, Kina, e cila është renditur e 23-ta për sa i përket suksesit olimpik në sportin e xhudos. Të gjitha medaljet olimpikë Kosova i ka të siguruar nga sporti i xhudos.

Ipswichi i shtohet garës për Brojën

Londër, 15 gusht - E ardhmja e sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, vijon të mbetet e paqartë. Pas shumë skuadrave që janë vënë pas sulmuesit të Chelseat, në Itali, Angli, Francë dhe Gjermani. Sipas medieve italiane, një skuadër tjetër ka dalë në pah dhe kërkon ta afrojë Brojën. Bëhet fjalë për skuadrën e sapongjitur në Premierë Ligë këtë sezon, Ipswich Town. Kështu pas Evertonit dhe Wolverhamptonit, Ipswichi bëhet ekipi i tretë, që në vetëm pak ditë i është “vënë pas” sulmuesit kuqezi. Kujtojmë që vetëm pak ditë më parë ishin gjermanët e Stuttgartit, të cilët, sipas medieve, ishin në “pole-position” për Brojën, por duket se lajmet për sulmuesin e kombëtares shqiptare nuk do të kenë të përfunduar derisa do të mësojmë njëherë e mirë ekipin e radhës në karrierën e Brojës.



Owens emërohet trajner i KB Ylli

Suharekë, 15 gusht - Skuadra e basketbollit, Golden Eagle Ylli, ka njoftuar se John Casey Owens do të jetë trajner i ri. Klubi nga Suhareka beson se

trajneri amerikan do t'i sjellë energji dhe fitore të reja klubit. “Kemi arritur marrëveshje me trajnerin amerikan John Casey Owens, i

cili vjen me një përvojë si trajner në G-League, asistent në NBA në ekipin LA Lakers, si dhe së fundmi udhëhoqi ekipin Kazma SC në Kuwait.

Ai do të na udhëheqë në drejtimin e fitoreve të reja. Le të fillojmë këtë aventurë të re dhe të mbushur me energji”, ka njoftuar KB Ylli.

Ancelotti: Privilegj të jem në krye të Realit

Madrid, 15 gusht - Suksesi kundër Atalantës ka qenë i veçantë edhe për trajnerin e Realit të Madridit, Carlo Ancelotti. Për italianin ky ka qenë trofeu i 14-të me ekipin spanjoll, duke bërë që ai ta arrijë legjendën e stolit të “Los Blancos”, Migel Munjoz. “Është

nder dhe privilegj për mua të jem në krye të stolit të Realit dhe të arrij të tilla shifra. Jam krenar që ky klub më ka bërë të jetoj këto net këtu, duke vuajtur... por edhe duke fituar”, ka thënë Ancelotti. Më pas ai ka analizuar takimin, duke theksuar vështirësitë në

pjesën e parë dhe shpërthimin e ekipit në pjesën e dytë. “Pjesa e parë na kushtoi shumë, por ata e paguan sforcon e tyre në pjesën e dytë ku ne ishim më mirë. Ata fituan më shumë duele se ne në pjesën e parë. Në të dytën kishim më shumë hapësirë dhe Rodrigo, Mbappe dhe Vinicius

janë shumë të mirë kur kanë hapësira përpara. Duhet t'i falënderojmë lojtarët që erdhën një javë më parë dhe që arritën formën shumë të mirë vetëm pak ditë para finales”, ka shtuar ai. Në fund ai ka folur edhe për Mbappen dhe premtimin e



francezit për 50 gola. “Mbappe ka cilësinë për të shënuar shumë gola, por ne duhet ta gjejmë ekuilibrin në skuadër. Gjithnjë ka vend për përmirësim”.

Kryeministri Rama përgëzon ekipin olimpiq për suksesin historik

Tiranë, 15 gusht - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e ka pritur ekipin olimpiq të Shqipërisë, i cili mori pjesë në Lojërat Olimpikë “Paris 2024”. Shqipëria i fitoi dy medaljet e para olimpikë në histori falë mundësve të natyralizuar Chermen Valiev e Islam Duadev. Rama i përgëzoi sportistët për paraqitjet në Olimpiadë duke besuar se edhe në të ardhmen kuqezinjtë do të tregohen të suksesshëm në Lojëra Olimpikë, duke e shprehur gatishmërinë e tij për ta dhënë kontributin në zhvillimin e sportit shqiptar, prej nga edhe mund të vijnë më pas sukseset e reja. “Suksesi historik i ekipit olimpiq shqiptar me sportistët Chermen Valiev dhe Islam Duadev në Lojërat Olimpikë ‘Paris 2024’, fryt i punës së palodhur dhe



sakrificës së tyre në radhë të parë, por dhe trajnerëve, federatës, Komitetit Olimpik Shqiptar dhe mbështetjes së qeverisë shqiptare, me sistemin e shpërblimeve për fituesit e medaljeve olimpikë dhe trajnerët e tyre që është më i miri në të gjithë rajonin. Tanimë

prej kohësh janë vendosur me vendime qeveria shpërblime të veçanta për medalistët dhe trajnerët e tyre, duke u dhënë sportistëve tanë një motivim më shumë për ta vazhduar rrugëtimin drejt majave më të larta të sportit botëror”, ka shkruar Rama.

Shaqiri largohet nga Chicago Fire: Koha të shikoj mundësi të reja në karrierën time

ÇIKAGO, 15 GUSHT - Xherdan Shaqiri dhe skuadra e MLS në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Chicago Fire, kanë ndërprerë bashkëpunimin me marrëveshje të dyanshme. Lajmin për largimin e tij e ka bërë Chicago Fire, pas dy vitesh qëndrim në klub të Shaqirit. “Pas diskutimeve me Xherdanin, me marrëveshje të dyanshme kemi ndarë rrugët. E falënderojmë atë për kontributin në klub dhe i dëshirojmë më të mirën në kaptinën e ardhshme të karrierës”, ka thënë drejtori sportiv i klubit, Georg Heitz. 32-vjeçari Shaqiri u transferua te Chicago Fire më 9 shkurt të vitit 2022 nga Lioni, ku zhvilloi 75 ndeshje, prej të cilave 63 herë ishte titullar, ndërsa realizoi 16 gola dhe regjistroi 20 asistime



në të gjitha garat. “Besoje se është koha e duhur për mua që të shikoj mundësi të reja në karrierën time. Dua ta falënderoj klubin dhe tifozët për përkrahjen që e kam pasur gjatë

kohës time në Chicago. Chicagos i dëshiroj më të mirën në vazhdim”, deklaroi Shaqiri. Shaqiri ka bërë karrierë te klube si Basel, Bayern Munich, Inter, Stoke City, Liverpooli dhe Lyon.

SHKURT

Mbappe: Mund të shënoj 50 gola në sezon

Sulmuesi i Francës, Kylian Mbappe, e nisi në mënyrën më të mirë të mundshme aventurën e tij te Real Madridi. Në ndeshjen e parë zyrtare me fanellën e “Los Blancos”, Mbappe realizoi gol dhe fitoi trofeun e Superkupës së Evropës në ndeshjen ndaj Atalantës. “Kur thua Real Madrid, thua trofe. Është klubi më i mirë në botë”, u shpreh francezi 25-vjeçar pas përfundimit të ndeshjes. Mbappe thotë se nuk ka limite dhe mund të shënojë 50 gola në sezon. “Ne jemi në Real Madrid, nuk kemi kufi, unë nuk kam kufi. Nëse mund të shënoj 50 gola, janë 50. Por gjëja më e rëndësishme është të fitojmë dhe të përmirësohemi si ekip, sepse do të fitojmë si ekip”, ka shtuar Mbappe.

LeBron: Nuk besoj se do të jem në Olimpiadën e shtëpisë

Basketbollisti amerikan LeBron James u vlerësua si MVP i Lojërave Olimpikë “Paris 2024” në këtë sport. Ai fitoi medaljen e tij të tretë të artë me kombëtaren amerikane në Olimpiadë, duke qenë protagonist në Paris. Tashmë 39-vjeçar, veterani i NBA-së shprehet se do të jetë e vështirë, madje e pamundur që ai të luajë ende në një event të tillë. Olimpiada e ardhshme do të zhvillohet në Los Anxhelos, shtëpinë e tij aktuale, pasi luan me lakersat. “Nuk e shoh veten duke luajtur për Amerikën pas katër vjetësh në Lojërat Olimpikë. Madje, të jem i sinqertë, nuk prisja të luaja as këtu në Paris këtë vit. Nuk e shoh dot veten time në fushë në atë turne”, u shpreh LeBron James.

Bellinghami, lojtari i ndeshjes në Superkupë

Jude Bellingham i Real Madridit është shpallur lojtari më i mirë i ndeshjes së Superkupës së Evropës. “Ai e shtyu përpara ekipin në pjesën e dytë duke fituar duele dhe ka bërë vrapime të mira para. Ai shfaqti përdorim të shkëlqyer të topit, bashkë me kualitetin e liderit. Po ashtu, dhuroi asistim në golin e dytë”, ka shkruar UEFA. Anglezi 21-vjeçar asistoi te goli i Kylian Mbappes derisa ishte pjesë kryesore e aksionit edhe te goli i Federico Valverde.

Pochettino, trajner i ri i ShBA-së

Mauricio Pochettino ka pranuar ofertën e Federatës Amerikane të Futbollit, për të qenë në krye të kombëtares së ShBA-së. Sipas medias spanjolle “Marca”, konfirmimi për këtë lëvizje do të bëhet gjatë kësaj jave. Tekniku argjentinas do ta drejtojë kombëtaren amerikane në Botërorin 2026, që do të mbahet në ShBA, Kanada dhe Meksikë.

Kane: Duhet ta rikthejmë Bayernin te fitoret e trofetë

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Harry Kane, mezi po e pret startin e sezonit të ri. Ai është rikthyer së fundi në radhët e gjigantëve “bavarezë” pas përfundimit të pushimeve të tij (mbas Kampionatit Evropian). Bayern

Munchen kaloi një përvojë me të cilën nuk ishte mësuar. Në sezonin 2023-2024 nuk fitoi dot asnjë trofe midis atyre që ishin në dispozicion. “Dua të vazhdoj të shënoj gola dhe ta ndihmoj ekipin. Një gjë është e qartë: ne

duhet ta kthejmë Bayernin në rrugët e fitoreve”, ka thënë Kane për “Bild”. Ndërkohë, Bayerni do të përballet me SSV Ulm në raundin e parë të Kupës së Gjermanisë dhe Kane po “vë bast” gjithçka për trajnerin e ri, Vincent

Kompany: “Jam shumë i emocionuar të shoh se si do të shkojë me trajnerin e ri, si do të luajmë. Do të kemi shumë raste për të shënuar. Kjo është mënyra perfekte për të luajtur, siç e shoh unë. Padyshim që do të ketë më

shumë punë, e vura re që në 10 minutat e para kundër Tottenhamit. Ishin 10 minuta shumë të vështira, por më pëlqen ky intensitet, më pëlqen ta fitoj topin sa më shpejt të jetë e mundur”.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kojshia” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811302926 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kojshia” D.O.O. Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811302926 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Kojshia” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811302926 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Lisjan Caka shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme “Mehmet Akif College” Banull KK Lipjan nga kl. 10.11.12.

Artan Myrtaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shtk “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L